

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6721
E hënë, 3 tetor 2022
çmimi 0.40

Nëntë shtete evropiane mbështesin anëtarësimin e Ukrainës në NATO



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FILLON MËSIMI



Pas një muaji grevë në arsim, sot (e hënë) fillon mësimi në të gjitha shkollat e Kosovës. Kreu i Këshillit Grevist, Rahman Jasharaj, ka thënë se greva nuk është mbyllur, por është pezulluar deri në janar të vitit 2023. Këtë vendim të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (SBASHK) e ka mirëpritur ministrja e

Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, e cila ka thënë se greva ka shkaktuar "dëm të madh", duke theksuar se duhet angazhim për t'i përmirësuar këto humbje. E opozita e ka fajësuar qeverinë Kurti që mësimdhënësit po e fillojnë vitin shkollor kokulur, të fyer dhe të lënduar

AKTUALE




KURTI, ÇEKU DHE KRASNIQI VIZITUAN ASETET E RESTAURUARA TË TRASHËGIMISË KULTURORE F. 6

KURTI FTON SHOIPTARËT NË SERBI TË MARRIN PJESË NË REGJISTRIMIN E POPULLSISË F. 3

FSK-JA VAZHDON STËRVITJET F. 6



EKONOMI



KURSIMI I (PA)MUNDSHËM I RRYMËS F. 6

SPORT



BALLKANI FITON DERBIN NDAJ GJILANIT F. 10



MAVRAJ VIZITON LIDERËT E UÇK-së NË HAGË: JANË BRILANTË NË ÇDO PIKËPAMJE DHE TEJET UNIKË

RENOVA
Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nëntë shtete evropiane mbështesin anëtarësimin e Ukrainës në NATO

BRUKSEL, 2 TETOR - Nëntë shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore kanë ofruar mbështetjen e tyre që Ukraina të bëhet anëtare e NATO-s dhe i kanë bërë thirrje Aleancës që t'i ofrojë më shumë armë Kievit në mënyrë që të mbrohet nga forcat pushtuese ruse.

Deklarata e lëshuar më 2 tetor u nënshkrua nga liderët e Republikës Çeke, Estonisë, Lituaniës, Letonisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Polonisë, Rumanisë dhe Sllovakisë.

Deklarata e përbashkët e këtyre nëntë shteteve vjen pasi presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, deklaroi më 30 shtator se Ukraina ka dorëzuar kërkesën për aplikim për anëtarësim në NATO përmes procedurës së përshtetshme.

Kjo kërkesë e Ukrainës u bë në ditën e njëjtë që presidenti rus Vladimir Putin pretendoi se Rusia ka aneksuar katër rajone ukrainase, që janë pjesërisht të pushtuara nga forcat ruse. "Ne përsërisim mbështetjen tonë



për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Ne nuk i njohim dhe nuk do t'i njohim kurrë përpjekjet ruse për të aneksuar territor ukrainas", u tha në deklaratën e nëntë liderëve të shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Deklarata e Putinit se Rusia ka

aneksuar rajonet e Donjeckut, Luhanskut, Hersonit dhe Zaporizhzhës, u pa si përshkallëzim i madh nga ana e Kremlinit.

I pyetur për kërkesën e Ukrainës për t'u anëtarësuar në NATO, sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, Jens Stoltenberg, tha për një televizion amerikan se

"çdo vendim për anëtarësim duhet të merret me konsensus dhe se të 30 aleatët duhet të pajtohen që të merret një vendim i tillë".

Stoltenbergu tha, po ashtu, se rimarrja e kontrollit të qytetit të Limanit nga forcat ukrainase qytet që gjendet në Donjeck është dëshmi se ukrainasit po

bëjnë përparim dhe janë në gjendje t'i dëbojnë nga territori forcat ruse. "Ne kemi parë se ata ishin në gjendje të merrnin një qytet të ri, Limanin, dhe ky fakt dëshmon se ukrainasit po bëjnë përparim, janë në gjendje t'i dëbojnë forcat ruse për shkak të kurajës së tyre, për shkak të trimërisë dhe aftësive të tyre dhe natyrisht për shkak të armëve të avancuara që Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tjerë po ua ofrojnë", tha Stoltenbergu gjatë një interviste për NBC. Sipas tij, mënyra më e mirë për ta kundërshtuar pretendimin rus për aneksimin e pjesëve të Ukrainës është vazhdimi i mbështetjes për qeverinë në Kiev.

Ndërkaq, më 2 tetor, ministrja gjermane e Mbrojtjes, Christine Lambrecht, njoftoi se vitin e ardhshëm do të dërgohen në Ukrainë 16 autobusë që janë prodhuar në Sllovaki. Këto armë do të financohen nga Danimarka, Norvegjia dhe Gjermania.

Zelensky: Kemi kontrollin e plotë të qytetit të Limanit



KIEV, 2 TETOR - Presidenti i Ukrainës tha se forcat e tij kanë kontrollin e plotë të qytetit lindor të Limanit, një qytet strategjik në Donbas, nga i cili forcat ruse u tërhoqën një ditë më parë.

Zelensky i bëri këto komente përmes një videomesazhi të postuar në llogarinë e tij në "Telegram" më 2 tetor. "Deri në orën 12:30 Limani është krejtësisht i pastruar", tha ai. "Faleminderit ushtarëve tanë! Lavdi Ukrainës!", shtoi presidenti ukrainas.

Rimarrja e kontrollit të Limanit nga forcat ukrainase është fitorja

më e madhe në fushëbetejë në javët e fundit, pas kundëroffensivës që forcat e Kievit nisën në rajonin verior të Harkivit, duke dëbuar forcat ruse. Suksesi i kësaj kundëroffensive befaso i shumë vëzhgues.

Limani është qytet strategjik përmes së cilit kalojnë linjat hekurudhore dhe analistët thanë se ka të ngjarë që forcat ukrainase do ta përdorin qytetin si vend prej ku do të nisnin ofensiva të reja në lindje.

Në Liman ka pasur luftime të ashpra në ditët e fundit, me forcat ukrainase që gradualisht arritën

të rrethonin rreth 5 000 trupa ruse që po e mbronin qytetin.

Ministria e Mbrojtjes së Rusisë tha më 1 tetor se trupat ruse po tërhiqeshin për shkak të "rrezikut të rrethimit".

Disa raportime të pakonfirmuara thanë se forcat ruse kishin pësuar humbje të mëdha të njerëzve dhe se një numër i paspecifikuar i ushtarëve ishin burgosur.

Kjo ishte humbja e fundit për presidentin rus, Vladimir Putin, që erdhi vetëm një ditë pasi ai tha se Rusia po anekson katër rajone ukrainase që kanë qenë



pjesërisht të pushtuara nga forcat ruse për disa muaj.

Rajoni i Donjeckut, ku gjendet Limani, është një prej katër rajoneve që Putini tha se Moska i aneksoi.

Kievi dhe Perëndimi kanë dënuar aneksimin, duke thënë se është i paligjshëm dhe farsë. "Çlirimi i këtij qyteti në rajonin e Donjeckut është një prej faktorëve kyç për çlirim të mëtejshëm në rajonin e Luhanskut", tha Serhiy Haida, kreu i administratës ushtarake ukrainase në Luhansk.

Putini ka deklaruar se Rusia ka

aneksuar Donjeckun, Luhanskun, Hersonin dhe Zaporizhzhën. Vëzhguesit kanë thënë se këto veprime të udhëheqjes ruse shuajnë edhe më shumë shpresat për arritjen e një marrëveshjeje të paqes.

Së bashku me Krimenë, që Moska aneksoi më 2014, katër rajonet ukrainase përbëjnë rreth 20 për qind të territorit të Ukrainës, dhe në to gjenden disa prej pjesëve më të industrializuara të shtetit.

Kievi ka thënë se nuk do të negociojë me Moskën për aq kohë sa Putini është në pushtet.

Mavraj viziton liderët e UÇK-së në Hagë: Janë brilantë në çdo pikëpamje dhe tejet unikë



HAGË, 2 TETOR - Profesori universitar, publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, i shoqëruar edhe nga drejtori i gazetës dhe ish-i burgosuri, i cili i mbijetoi masakrës në burgun e Dubravës, Sadik Zeqiri, i ka vizituar një ditë më parë në

Hagë liderët e UÇK-së. Mavraj, lider i Lëvizjes Studentore të 1 tetorit 1997, pas kësaj vizite ka shkruar në "Facebook" për takimin që ka zhvilluar me liderët e UÇK-së. Ai thotë se ata ishin brilantë në çdo pikëpamje dhe tejet unikë. "Takimet u kryen këtu në

Hagë. I nderuam dhe na nderuan jo vetëm për 25-vjetorin e 1 tetorit 1997. Janë brilantë në çdo pikëpamje. Dhe, tejet unikë. Për ata që e kanë projektuar harrimin e tyre dhe ngritjet lart mbi fatin dhe kurrizin e këtyre burrave, dy fjalë: duke i mbajtur kaq

kot e kaq padrejtësisht strategët e lirisë, ky vend këtu po bëhet e kundërta, vend pelegrinazhi ku s'bën pa shkuar së paku një herë", ka shkruar Mavraj. Ai këtë vizitë e ka realizuar me rastin e 25-vjetorit të protestave studentore të '97-s.

"Në këtë jubile sot do të përqafohem me strategët e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Nga të gjallët në këtë 25-vjetor, askush më shumë sesa këta nuk meriton respektin dhe përkrahjen", pati shkruar Mavraj pak orë para se të takohej me liderët e UÇK-së.

Kurti fton shqiptarët në Serbi të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë



PRISHTINË, 2 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka ftuar shqiptarët që jetojnë në Serbi të marrin pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë dhe të pronës.

Ky proces ka nisur më 1 tetor dhe do të zgjasë deri në fund të po këtij muaji.

Përmes një videomesazhi të publikuar në rrjetet sociale, Kurti tha se shqiptarët që jetojnë në Serbi "vazhdimisht përballen me diskriminim kombëtar e njerëzor, së fundmi edhe me pasivizimin e adresave të tyre". Spas Kurtit, ky proces për shqiptarët nuk është vetëm çështje statistike. "Si

kryeministër i Republikës së Kosovës ftoj shqiptarët që jetojnë në Serbi, në veçanti në komunat Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, që t'u përgjigjeni regjistruarve, duke regjistruar veten e familjarët. Ju ftoj që shtypjes t'i përgjigjeni me regjistrim. T'i përgjigjeni pasivizimit duke regjistruar çdo shqiptar. Edhe ata që gjenden me banim të përkohshëm në diasporë dhe Kosovë. Të dëshmoni me vendosmëri që jeni aty", tha Kurti.

Përfaqësuesit politikë nga të gjitha partitë që përfaqësojnë komunitetin shqiptar në Serbi, përmes një deklarate të

nënshkruar në korrik të këtij viti, u zotuan se do të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë, amvisërive dhe banesave në Serbi.

Shqiptarët në jug të Serbisë në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, e kishin bojkotuar regjistrimin e popullsisë më 2011. Sipas vlerësimeve të bashkësisë ndërkombëtare, në Serbi jetojnë rreth 60 mijë shqiptarë, kryesisht në tri komunat në jug, që njihen edhe me termin Lugina e Preshevës.

Në vazhdimësi partitë politike të shqiptarëve në Serbi janë ankuar se pakica shqiptare përballet me diskriminim. Ata,

po ashtu, kanë shprehur shqetësimin për procesin e pasivizimit të adresave që, sipas politikanëve shqiptarë, po bëhet për ta ndryshuar "strukturën etnike" të tri komunave ku jetojnë shumica e pakicës shqiptare në Serbi.

Më 2021 Komiteti i Helsinikut për të drejtat e njeriut në Serbi tha se Beogradi zyrtar, në mënyrë që ta ulë numrin e shqiptarëve në Luginë të Preshevës, po kryen procesin e "pasivizimit të banorëve shqiptarë" që jetojnë jashtë Serbisë, qoftë në Kosovë apo në shtetet evropiane. "Kjo masë, në thelb, është një formë e

spastrimit etnik përmes mjeteve administrative", thuhej në raportin e Komitetit të Helsinikut. Sipas Komitetit të Helsinikut, kur një adresë e banimit pasivizohet dhe hiqet nga libri amëz në Serbi, "ai person praktikisht pushon së ekzistuari". Personave që u pasivizohen adresat nuk mund të pajisen me letërnjoftim apo pasaportë të re. Rrjedhimisht, sipas Komitetit të Helsinikut, atyre u parandalohet ta regjistrojnë makinën e tyre, të blejnë apo shesin pronë, të kenë qasje në kujdesin shëndetësor dhe në shërbimet sociale dhe të votojnë në zgjedhje, qofshin ato lokale apo të përgjithshme.



Fillon mësimi

Pas një muaji grevë në arsim, sot (e hënë) fillon mësimi në të gjitha shkollat e Kosovës. Kreu i Këshillit Grevist, Rahman Jasharaj, ka thënë se greva nuk është mbyllur, por është pezulluar deri në janar të vitit 2023. Këtë vendim të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (SBASHK) e ka mirëpritur ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, e cila ka thënë se greva ka shkaktuar “dëm të madh”, duke theksuar se duhet angazhim për t’i përmirësuar këto humbje. E opozita e ka fajësuar qeverinë Kurti që mësimdhënësit po fillojnë vitin shkollor kokulur, të fyer e të lënduar

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 TETOR - Sot (e hënë) në të gjitha shkollat do të nisë mësimi, pasi Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (SBASHK) ka njoftuar se greva në arsim është pezulluar. Kreu i Këshillit Grevist, Rahman Jasharaj, ka thënë në një konferencë për medie se greva nuk është mbyllur, por është pezulluar deri në janar të vitit 2023. Ai porositi qeverinë që ta shfrytëzojë këtë kohë për dialog me sindikalistët dhe mos ta marrë “si fitore, sepse nuk ka fituar askush”. “Nga qeveria kërkojmë që të takohemi në dialog të sqartë për t’i realizuar kërkesat legjitime të anëtarësisë. Uroj që Qeveria dhe Kuvendi ta mbajnë fjalën për Ligjin e Pagave, për ndryshimin e Ligjit të Skemave Pensionale, e sidomos për kriterin

diskriminues për 15 vjet kontributdhënie para vitit 1990. Uroj që të punohet bashkërisht Ligji për Sigurime Shëndetësore. Uroj që tri palët në këshillin ekonomik-social ta nënshkruajnë Marrëveshjen Kolektive, diçka që është bazament për të drejtat e sindikalistëve në Kosovë”, ka thënë Jasharaj. Ndërkaq kreu i BSPK-së, Atdhe Hykollli, ka thënë se greva nuk ishte akt individual ose një grupi individësh, por tha se ishte mjet i veprimit sindikal, duke shtuar se greva e tyre ishte e ligjshme. Greva në arsim dhe në administratën publike në nivelin lokal dhe qendror nisi më 25 gusht. Deri te pezullimi i grevës u tha se erdhi pas votimit të anëtarësisë të sindikalistëve. Në sindikatën e arsimit, 54.88 për qind e anëtarësisë ka votuar për pezullimin e grevës deri në janar. Për shkak të grevës, për gati pesë javë mbi 300 000

nxënës mbetën jashtë bankave shkollore. Sindikalistët kërkuar 100 euro për punëtor për çdo muaj deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga. Por, Qeveria publikoi një pako për ndihmë për shkak të rritjes së inflacionit dhe në të u parapanë 50 euro për të gjithë punëtorët e sektorit publik. Qeveria së fundmi ka hartuar Projektligjin për Paga dhe i njëjti është në procedura të konsultimeve publike. Ai më pas duhet të miratohet në Qeveri dhe Kuvend, e më pas të publikohet në Gazetën Zyrtare. Tetë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, ky legjislacion pritet të hyjë në fuqi

MASHTI mirëpret ndërprerjen e grevës

Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci,

ka mirëpritur vendimin për nisjen e vitit të ri shkollor, por tha se greva ka shkaktuar “dëm të madh”, andaj ajo tha se duhet angazhim për t’i përmirësuar këto humbje. “Kalendari i vitit shkollor duhet të ndryshohet, andaj menjëherë të hënë, më 3 tetor, do ta formojmë grupin punues për të rishikuar këtë Udhëzim Administrativ. Do ta vazhdojmë punën me intensitet të shtuar për përmirësimin e legjislacionit për licencimin e mësimdhënësve, vlerësimin e performancës dhe realizimin e shtesës së performancës”, ka shkruar ajo në “Facebook”, duke u bërë thirrje institucioneve komunale që të ndërmarrin masa që mësimi të nisë të hënë. Ajo ka thënë se drejtoritë komunale të arsimit duhet t’i marrin të gjitha masat që të hënë gjithçka të jetë gati për ta filluar mësimin në shkolla e punën në çerdhe, pa asnjë pengesë. “Ftojmë prindërit, mësuesit e udhëheqësit e shkollave për bashkëpunim të shtuar. Duhet të jemi unikë për kryerjen e misionit fisnik për edukimin e arsimimin e fëmijëve tanë. Do t’i vazhdojmë vizitat e takimet në komuna e shkolla për të dëgjuar e adresuar secilën brengë e ide të nxënësve,

mësuesve, prindërve e udhëheqësve të shkollave”, ka deklaruar Nagavci. Ajo ka theksuar se si Qeveri e Ministri e Arsimit do të vazhdojnë të kenë në vëmendje përmirësimin e kushteve të punës në çerdhe e shkolla, ofrimin e mundësive të barabarta për nxënësit e studentët. “Po ashtu, mbështetjen e punëtorëve të arsimit drejt përmirësimit të mësimdhënies së tyre, bashkëpunimin me komunitetet e institucioneve edukativo-arsimore, prindërit e nxënësit dhe angazhimin e përbashkët për përmirësimin e rezultateve në arsim, për shkolla të sigurta e ambiente miqësore. Në këtë drejtim tashmë kemi ndërmarrë një varg veprimesh konkrete dhe nuk do të ndalemi me qaq”, është shprehur Nagavci, duke theksuar se në Projektligjin e ri për Paga punëtorët e arsimit për herë të parë janë trajtuar dinjitetshëm dhe do ta kenë koeficientin më të lartë se që e kanë pasur ndonjëherë. “Me këtë rast, ftoj të gjithë mësimdhënësit që ta japin kontributin e tyre me komente e sugjerime, që të kemi një projektligj sa më të mirë për pagat. Ashtu siç kam vepruar që nga dita e parë e detyrës, jam e hapur për dialog social, angazhim të përbashkët për

Kosova me popullsinë më të re në rajon

PRISHTINË, 2 TETOR - Përmirësimi i kujdesit shëndetësor, ushqimi më i mirë, kushtet e jetesës dhe shumë faktorë të tjerë janë arsyeja e rritjes së përqindjes së personave mbi 65 vjeç në pothuajse të gjitha vendet e botës. Me pak fjalë, bota po plakët, po ashtu edhe popullsia në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Edhe pse në nivel global shihen vetëm pak më pak se një e dhjeta e popullsisë së botës njerëz mbi 65 vjeç, megjithatë në shumë vende kjo përqindje është shumë më e lartë dhe arrin mbi një të tretën e banorëve të një vendi.

Statistikat demografike për moshën e popullsisë janë të rëndësishme nga shumë

aspekte nga organizimi dhe planifikimi i fondeve pensionale, ndërtimi i institucioneve për kujdesin e njerëzve, trajtimi spitalor etj.

Sa i përket përqindjes së banorëve më të vjetër se 65+ në rajonin e Ballkanit Perëndimor, organizata globale statistikore Statista ka të dhëna për Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, por jo për Kosovën, Shqipërinë dhe Bosnjë- Hercegovinën, ndaj duhet kërkuar të dhëna për ta nga burime të tjera.

Sipas Statista-s, Serbia ka përqindjen më të lartë të popullsisë së moshuar në Ballkanin Perëndimor me 21.3 për qind të popullsisë mbi 65 vjeç. Mali i Zi ka 15,9 për qind të

popullsisë së përgjithshme që është më e vjetër se 65 vjeç ndërsa, sipas të dhënave të Statista-s për Maqedoninë e Veriut, 14,8 për qind e popullsisë është më e vjetër se 65 vjeç.

Nëse analizohen të dhënat e reja statistikore të marra nga regjistrimi i popullsisë i vitit të kaluar dhe të publikuara këtë vit, vijmë deri tek e dhëna se popullsia është "plakur" dhe tani janë 17.1 për qind e banorëve që janë mbi 65 vjeç.

Sipas organizatës statistikore Knoema, Shqipëria ka 15.2 për qind të popullsisë mbi 65 vjeç dhe Bosnjë-Hercegovina 18.5 për qind, që do të thotë se, nëse të dhënat janë të sakta, ajo është menjëherë pas Serbisë për sa i

përket përqindjes së popullatës së moshuar.

Sipas një burimi të tretë, Kosova ka popullsinë më të re në rajon. Sipas Index Mundi, Kosova ka vetëm 7.75 për qind të popullsisë që është mbi 65 vjeç. Japonia ka 86 000 njerëz mbi 100 vjeç.

Në kuadër të Bashkimit Evropian, Italia ka përqindjen më të lartë të popullsisë së moshuar, 23.5 për qind të popullsisë. Më pas vjen Finlanda me 22,7 për qind, e ndjekur nga Greqia me 22,5 për qind.

Gjithsej 16 vende në tokën evropiane kanë mbi 20 për qind popullsi të moshuar.

Nga vendet në Evropë, Luksemburgu (14.6 për qind)

dhe Turkiye (9.7 për qind) shënuan përqindjen më të ulët të të moshuarve.

Sipas parashikimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, deri në vitin 2050 vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme do të jenë shtëpia e 80 për qind të popullsisë së moshuar të botës. Për ta rritur ndërgjegjësimin për këtë temë, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka shpallur periudhën kohore midis 2021 dhe 2030 si "Dekada e plakjes së shëndetshme".

Nisma synon "t'i reduktojë pabarazitë shëndetësore dhe ta përmirësojë jetën e të moshuarve, familjeve dhe komuniteteve të tyre nëpërmjet veprimit kolektiv".



përmirësim të kushteve të punës, rezultate në arsim si dhe avancim të pozitës së mësimdhënësve. Mirëpresim dialogun social e bashkëpunimin e sinqertë, ashtu si urojmë që për të gjithë interesi më i mirë i fëmijëve të jetë në radhë të parë", ka deklaruar ministrja Nagavci.

Opozita e lumtur për fillimin e mësimin, por e kritikon qeverinë

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka shkruar në "Facebook" për fillimin e mësimin më 3 tetor, pas pezullimit të grevës një mujore

nga SBASHK-u. Ai ka thënë se është i lumtur që fëmijët po kthehen në bankat e shkollës, por thotë se është i shqetësuar për qasjen që ka pasur qeveria ndaj grevës së mësimdhënësve. "Jam shumë i lumtur që fëmijët po kthehen nesër në bankat e shkollës, mirëpo jam edhe i shqetësuar për modelin

qeverisës që po instalohet. Në kohën kur nxënësit do të shkojnë kokëlartë në shkollë, Qeveria e Kosovës, përmes sulmeve të shumta, për herë të parë bëri që mësimdhënësit ta fillojnë vitin shkollor kokulur, të fyer e të lënduar", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka shtuar se përtej

propagandës, mësimdhënësit mbeten një ndër kategoritë më të respektuara të shoqërisë sonë. "Por, ata meritojnë edhe trajtim të drejtë që e ruan dinjitetin e tyre. Prandaj, kërkesat e tyre, me apo pa grevë, duhet të adresohen dhe të plotësohen sa më shpejt", ka shkruar lideri i PDK-së.

KFOR-i hap ekspozitë në parkun memorial "Heroinat"

PRISHTINË, 2 TETOR - KFOR-i ka hapur një ekspozitë në parkun memorial "Heroinat" dhe do të jetë e hapur deri më 15 tetor. Kjo ekspozitë ngërthen në vete disa nga momentet më të bukura të shkrepura nga vetë ushtarët e

KFOR-it gjatë kohës së tyre në detyrë. "Për një përvojë edhe më të bukur, ju sugjeroj ta vizitoni pas orëve të mbrëmjes, për të pasur mundësi t'i përjetoni emocionet dhe ngjyrat vibrante që kjo ekspozitë

ofron. Falënderoj KFOR-in për realizimin e kësaj ekspozite krahas kontributit të vazhdueshëm për ofrimin e sigurisë për qytetarët tanë!", ka shkruar në "Facebook" kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.



Kurti, Çeku dhe Krasniqi vizituan asetet e restauruara të trashëgimisë kulturore



PEJË, 2 TETOR - Për ta parë nga afër zbatimin e programit për ndërhyrje restauruese në asetet e trashëgimisë kulturore, kryeministri Albin Kurti, bashkë me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku dhe ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, vizituan kullën e Sheremetit në Pejë, ndërtuar në shekullin XVIII, kullën e Tahirsylajve në Isniq të Deçanit, rreth 170 vjet e vjetër, Hanin e Haraqisë në

Gjakovë, të shekullit XVII, si dhe Muzeun Etnografik në Gjakovë, të shekullit XIX. Gjatë vizitave në monumentet e restauruara u theksua se për vitin 2022 është planifikuar buxhet prej 8.4 milionë eurosh, prej të cilave 1 milion euro janë për ndërhyrje emergjente. Po ashtu, u theksua që restaurimet përcillen me plane menaxhimi dhe funksionalizim të monumenteve.

Përveç ndërhyrjeve restauruese në asetet e vizituara, janë realizuar dhe janë duke u realizuar ndërhyrje restauruese në dhjetëra monumente: Muzeu Etnologjik Emingjiku në Prishtinë, Kulla e Sylejman Vokshit në Gjakovë, Kinemaja e Parë në Prizren, Hamami i Gazi Mehmet Pashës në Prizren, Hamami në Mitrovicë dhe në disa monumente brenda Qendrës Historike të Prizrenit.

Deputetja Musliu në Gjermani: Gratë e mërgatës në mbështetje të PDK-së

PRISHTINË, 2 TETOR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Ganimete Musliu, po qëndron në Regensburg të Gjermanisë ku ka takuar gra dhe vajza që jetojnë dhe punojnë në këtë qytet.

Deputetja Musliu ka theksuar se "këndvështrimet e tyre janë pragmatike dhe të qarta. Gratë dhe vajzat në diasporë presin nga ne më shumë angazhim, më shumë punë dhe përkushtim në rrugën tonë për ta rikthyer Partinë Demokratike të Kosovës në udhëheqje të shtetit".

Ajo ka deklaruar se mërgata është në mbështetje të nismave që kanë peshë dhe rëndësi për vendin e për kombin, duke shtuar se është nevojë dhe domosdoshmëri e kohës që PDK-ja të kthehet fuqishëm e ta qeverisë vendin.

Deputetja Musliu ka treguar se biseda u zhvillua rreth dy temave kryesore: avancimi i pozitës së gruas dhe proceset aktuale politike. "Kërkesat e tyre



flasin një gjuhë të pastër dhe pa hamendje. Avancimi i pozitës së gruas duhet të fokusohet në dy shtylla kryesore: Në luftimin e mentaliteteve të stërvjetëruara që në shoqërinë tonë u mbollën nga pushtuesit dhe në shkollimin cilësor të vajzave tona. Çdo qasje tjetër

është sipërfaqësore dhe rezultati do të jetë sipërfaqësor. Inspiruese është edhe gatishmëria e tyre për t'u bashkuar në kauza të vërteta për mbrojtjen e vlerave dhe të identitetit të PDK-së dhe atyre historike të Kosovës", ka shkruar Musliu në "Facebook".

Ajo ka theksuar se Partia Demokratike e Kosovës duhet të fokusohet në ngritjen e vetëdijes qytetare për ngritjen e kauzave kombëtare e shtetërore dhe të tregojë një vizion të qartë në raport me padrejtësitë që po u bëhen Hashim Thaçit, Kadri Veselit,

Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit, Calit, Nasimit e Hysniut. "Respekt e mirënjohje për mërgatën tonë e cila po vazhdon angazhimin e fuqishëm për mbështetjen e Kosovës dhe Partisë Demokratike të Kosovës", ka deklaruar Musliu.



FSK-ja vazhdon stërvitjet

PRISHTINË, 2 TETOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka publikuar disa fotografi të ushtarëve të FSK-së duke stërvitur me pesha të rënda. Ai tha se kadetëve iu testuan "pothuajse të gjithë komponentët e përgatitjes fizike, si qëndrueshmëria,

forca dhe kondicioni fizik". "Aromë beteje" është ecja e kadetëve tanë me pesha të rënda e përcjellë nga 2 km vrapim. Kadetëve iu testuan pothuajse të gjithë komponentët e përgatitjes fizike, si qëndrueshmëria, forca dhe kondicioni fizik.

Ecja me pesha simulon afrimin në zonën e operacionit, kurse vrapimi me pesha simulon luftëbërjen. Udhëheqësit e së ardhmes, sikurse shpirtërisht e psikikisht, janë të fortë edhe fizikisht", ka shkruar Mehaj në "Facebook".

Kursimi i (pa)mundshëm i rrymës



PRISHTINË, 2 TETOR - Autoritetet e Kosovës në vazhdimësi u kanë bërë thirrje qytetarëve të vendit ta kursejnë energjinë elektrike, sidomos gjatë muajve të dimrit, në mënyrë që niveli i shkurtimeve të energjisë të ulet. Sipas tyre, marrë parasysh që Kosova gjendet në rrjetin e përbashkët energjetik evropian, i cili po vuan nga kriza ekstreme energjetike, si pasojë e pushtimit rus të Ukrainës, situata energjetike në të cilën mund të gjendet vendi gjatë muajve të dimrit mbetet e paqartë dhe e pasigurt. Por, disa qytetarë të Prishtinës, ndonëse i vlerësojnë të arsyeshme rekomandimet e autoriteteve të vendit për kursim të energjisë elektrike, ata kanë pikëpamje të ndryshme nëse ajo mund të kursehet, veçanërisht gjatë muajve të ftohtë të dimrit. Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar se në sezonin e dimrit do të ketë reduktime të energjisë për shkak të mungesës së kapaciteteve prodhuese për të mbuluar kërkesën si dhe çmimit të shtrenjtë të importit të rrymës.

A mund të kursehet energjia elektrike?

Emirieta Zhegrova thotë se gjatë gjithë vitit përpiqet ta kursejë energjinë elektrike, duke vënë në funksion pajisjet shtëpiake vetëm kur janë tarifata e lira, gjatë natës. Por, sipas saj, situata pritet të komplikohet gjatë muajve të dimrit dhe kursimi i energjisë mund të jetë i vështirë. "Tash, pasi që është koha e dimrit, mund të jetë më problematike në qoftë se do të ketë

reduktime të energjisë. Ngrohjen e kemi me Termokosin [ngrohësja e qytetit të Prishtinës], por Termokosi është i lidhur me rrymë. Do të jetë shumë më problematik kursimi i rrymës në kohë të dimrit", thotë Zhegrova për Radion Evropa e Lirë.

Por, ndryshe mendon Nevruz Nushi. Ai shpreh mendimin se çështja e kursimit, përfshirë edhe atë të energjisë elektrike, më tepër varet nga shprehia e shpenzimit.

"Ngado që eci, e ndali rrymën. E kam në shpirt çështjen e kursimit, jo vetëm për rrymë, por edhe për ujë. Për shembull: të mos e lëshoj bojlerin [pa nevojë], të mos i lë dritat ndezur, pasi që lypset të kursehet rryma. Njerëzit tanë edhe ankohen, por edhe nuk janë në gjendje të dinë të kursejnë vetë së pari, por edhe t'i dëgjojnë këshillat e autoriteteve", thotë Nushi.

Por, pavarësisht thirrjeve, rekomandimeve dhe këshillave të autoriteteve ndaj qytetarëve që të kursejnë energjinë elektrike, Kompania Kosovare për Distribucionin e Energjisë Elektrike (KEDS), më 22 shtator ka thënë se "ditëve të fundit kërkesa për rrymë është rritur për 12 për qind, ndërkaq në kohën e pikut edhe 13 për qind", krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Sugjerimi "qesharak" për izolim shtëpish?

Më 29 shtator, ministrja e Ekonomisë e Qeverisë së Kosovës, Artane Rizvanolli, në seancën e Kuvendit të Kosovës ka folur për masat e kursimit

që ka ndërmarrë Qeveria, por edhe të mbështetjes së qytetarëve që nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet e energjisë elektrike. Ajo ka ripërsëritur kërkesën ndaj qytetarëve për kursim të energjisë elektrike. Për më shumë, ajo u ka sugjeruar familjeve kosovare "që të bëjnë izolimin e shtëpive para se të fillojnë temperaturat e ulëta". Kjo deklaratë ka ngjallur komente të ndryshme, mbështetëse dhe kundërshtuese, por edhe shaka të qytetarëve të Kosovës në rrjetet sociale. Megjithatë, qytetarët me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë, kanë shprehur pikëpamjet e tyre lidhur me sugjerimin e ministres Rizvanolli.

Emirieta Zhegrova e konsideron qesharak këtë sugjerim. "Secila familje, secili individ e di që izolimi i shtëpisë është më i mirë, si për kohë të verës, si për kohë të dimrit dhe jo vetëm për ta kursyer energjinë elektrike ose për ngrohje", thotë Zhegrova. Ndryshe mendon Nevruz Nushi. Sipas tij, sugjerimet e autoriteteve duhet marrë si këshilla të dobishme. "Këshillat janë gjithmonë shumë të mirëseardhura për ata njerëz që kanë vesh dhe që duan të hyjnë në normalitet, t'ia dinë hallin vetit dhe shoqërisë. Nëse nuk munden [t'i izolojnë shtëpitë] atëherë duhet të përshtaten, sepse nuk kanë nga t'ia mbajnë", thotë ai.

Edhe Elemidina Kurti nuk e vlerëson si qesharak sugjerimin për izolim të shtëpive. "Nuk është se mundet me qenë qesharak, nëse një njeri ka kushte që ta bëjë atë gjë. Po themi nëse... Pra, nëse ka

mundësi ta bëjë, një thirrje e tillë ndoshta mund t'ia rikujtojë që ta bëjë. Por, për njerëzit që nuk kanë mundësi ta mbulojnë këtë, po besoj që është e pamundur", thotë Kurti.

Ndërkaq, Hysen Gecaj, sugjerimin e ministres Rizvanolli për izolim të shtëpive, e sheh si joefikase e madje edhe joserioze. "Ato sugjerime nuk më janë dukur serioze, për shkak se t'iu thuhet qytetarëve 'izoloni shtëpinë tuaj', është paksa qesharake, sepse unë edhe pa me më thënë Qeveria kam dëshirë ta izoloj. Mirëpo, kah t'ia marr unë ato para për ta izoluar shtëpinë? Afërsisht rreth 8 000 euro nevojiten për izolimin e shtëpisë sime", u shpreh Gecaj.

Izolimi i shtëpisë, deri në 11 000 euro

Por, sa kushton izolimi i një shtëpie mesatare, muret e së cilës arrijnë deri 400 metra katrorë?

Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar kompaninë "Përparimi SHPK", e cila merret me shitjen e materialit ndërtimor dhe izolues.

Endrit Krasniqi nga kjo kompani, thotë se çmimet që përfshijnë materialin, por edhe mjeshtërinë për izolimin e një shtëpie të tillë, varen nga kualiteti i materialit izolues. "Për një shtëpi mesatare izolimi i mirë kushton diku 8 000 euro, më shumë ose më pak. Mesatarja, për 400 metra katrorë, bëhet rreth 10 000 euro. Në qoftë se izolimi bëhet me stiropor kushton 7 000 deri 8 000, nëse izolimi bëhet me lesh të gurit bëhet rreth 11 000 euro", shpjegon Krasniqi.

Fushatat për vetëdijesim dhe masat qeveritare

KEDS-i në vazhdimësi ka iniciuar fushata për vetëdijesim për kursimin e energjisë elektrike nga konsumatorët, duke dhënë një varg këshillash se s'i mund të bëhet kjo gjatë përdorimit të dritave për ndriçim, përdorimit të pajisjeve elektrike, makinave për larje të rrobave, të enëve, bojlerit dhe të tjera, në kohën kur tarifa është e ulët.

Me qëllim të kursimit të energjisë elektrike, Qeveria e Kosovës në muajin gusht ka miratuar masat emergjente që përfshinin masat e kursimit të energjisë elektrike nga të gjitha institucione, ndalimin e përdorimit të rrymës për mihjen e kritpvalutave dhe mbështetjen e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Tregut (KOSTT), që ky operator të ndërmarrë masat e duhura për të ofruar siguri të sistemit elektro-energjetik.

Në muajin shtator Qeveria e Kosovës i ka propozuar Kuvendit që t'i zgjasë masat emergjente për furnizimin me energji edhe për një muaj me qëllim që të ketë "normalizim të plotë" të gjendjes me rrymë. Por, ky propozim nuk ka kaluar në Kuvend.

Qeveria e Kosovës së fundmi ka thënë se po ndërmer masa për kursimin e energjisë elektrike. Sipas ekzekutivit, deri më tash janë subvencionuar faturat e energjisë së shpenzuar nga qytetarët për të gjithë konsumatorët e shërbimit universal. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar subvencionim shtesë për të gjithë ata konsumatorë që kursejnë energjinë elektrike.

Gjashtë zbulimet e fundit, të cilat e kanë ndryshuar mënyrën se si mendojmë mbi origjinën tonë



Nga Penny SPIKINS

Studimi shkencor i evolucionit njerëzor, na ka siguruar historikisht një rregull ngushëllues ndaj gjërave. Ai i ka përshkruar njerëzit si më të zgjuar, më intelektualë dhe më të kujdesshëm se paraardhësit tanë. Por zbulimet gjatë 5 viteve të fundit, e kanë përmbysur këtë pikëpamje të cekuilbruar.

1. Ka më shumë lloje njerëzore nga sa e kemi imagjinuar më herët

Specie të tilla si Homo Longi janë identifikuar vetëm në vitin 2018. Deri tani njihen 21 lloje qeniesh njerëzore. Vitet e fundit kemi kuptuar se paraardhësit tanë Homo Sapiens, mund të kenë takuar deri në 8 nga këto lloje të ndryshme njerëzish, nga specie të forta shtatlarta, përfshirë Neandertalët dhe të afërmit e tyre të afërt Denisovanët, deri tek shkurtabiqtë (më pak se 1.65 metra të gjatë) dhe me tru të vogël si Homo Naledi.

2. Njerëzit hibridë janë pjesë e historisë sonë

Llojet humanoide hibride, që

dikur shiheshin nga ekspertët si pjellë e fanta-shkencës, mund të kenë luajtur një rol kyç në evolucionin tonë. Dëshmia e rëndësishme së tyre vjen nga gjenetika. Gjurma nuk është vetëm në ADN-në e specieve tona (që përfshin gjene të rëndësishme të trashëguara nga Neandertalët), por edhe tek skeletet e qenieve hibride. Një shembull është “Deni” një vajzë me një nënë Neandertal dhe baba Denisovan. Eshtrat e saj u gjetën në një shpellë në Siberi.

3. Ne patëm fat

E kaluara jonë evolucionare është më e rrëmujshme nga sa e mendonin deri dje shkencëtarët. A jeni shqetësuar ndonjëherë për dhimbjen e shpinës? Apo e shihni me xheloz pas qenit tuaj teksa përshkoi një distancë më të madhe sesa ju? Kjo duhet të ishte e mjaftueshme për t’ju treguar se jemi larg përshtatjes së përsosur me botën. Ne e dimë prej disa kohësh se evolucioni i bashkon zgjidhjet në përgjigje të një ekosistemi që tashmë mund të ketë ndryshuar. Por shumë nga ndryshimet në linjën tonë evolucionare njerëzore mund të jenë

rezultat i rastësisë. Për shembull, aty ku popullatat e izoluara kanë një karakteristikë, siç është një aspekt i pamjes së tyre, që nuk bën shumë diferencë në mbijetesën e tyre, kjo formë vazhdon të ndryshojë tek pasardhësit. Tiparet e fytyrave të Neandertalëve (si vetullat e tyre të theksuara) ose të trupit (përfshirë kafazet e mëdha të brinjëve), mund të kenë ardhur thjesht nga zhvendosja gjenetike.

4. Fati ynë është i ndërthurur me natyrën

Neve mund të na pëlqejë ta imagjinojmë veten si padronë të mjedisit. Por është gjithnjë e më e qartë se janë ndryshimet ekologjike, ato që na kanë formësuar si qenie. Origjina e specieve tona përkoi me ndryshime të mëdha të klimës, pasi ne spikatëm në krahasim me shumë nga speciet e tjera në ato epoka.

Të gjitha llojet e tjera të njeriut, duket se janë zhdukur si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Tre speciet kryesore njerëzore Homo Erectus,

Homo Heidelbergensis dhe Homo Neanderthalensis u zhdukën pas ndryshime të mëdha të klimës siç është Ngjarja Adams, një prishje e përkohshme e fushës magnetike të Tokës 42.000 vjet më parë, e cila përkoi me zhdukjen e Neandertalëve.

5. Mirësia është një avantazh evolucionar

Studimet kanë zbuluar arsye të reja për të pasur më shumë shpresë për shoqëritë e ardhshme njerëzore. Shkencëtarët besonin deri dje se ishin pjesët e dhunshme të natyrës njerëzore, ato që na kanë dhënë avantazh në shkallaren e evolucionit. Por vitet e fundit kemi gjetur prova edhe për anën e kujdesshme të natyrës njerëzore dhe kontributin e saj në suksesin tonë. Skeletet e lashtë tregojnë shenja të jashtëzakonshme të mbijetesës nga sëmundjet dhe lëndimet, të cilat do të ishin të vështira nëse mos të pamundura pa ndihmën e ndërsjelltë. Gjurma e dhembshurisë njerëzore daton të paktën 1 milion e gjysmë vjet më parë. Shkencëtarët kanë zbuluar njohuritë mjekësore të paktën që nga koha e Neandertalëve. Altruizmi bart me vete shumë përfitime të

rëndësishme të mbijetesës. Ai u dha mundësi anëtarëve më të moshuar të komunitetit që të transmetonin njohuri të rëndësishme. Dhe kujdesi mjekësor i mbajti gjallë gjuetarët e aftë.

6. Ne jemi një specie e ndjeshme

Evolucioni na bëri më të ekspozuar emocionalisht, sesa duam që ta imagjinojmë. Ashtu si qentë shtëpiakë, me të cilët ndajmë shumë përshtatje gjenetike, si toleranca më e madhe për të huajt dhe ndjeshmëria ndaj shenjave sociale, hipersocialiteti njerëzor ka ardhur me një kosto: dobësia jonë emocionale. Ne jemi më të ndjeshëm ndaj mënyrës sesi ndihen njerëzit përreth nesh, dhe jemi më të prekshëm ndaj ndikimeve sociale, më të prirur ndaj çrregullimeve emocionale, ndaj vetmisë dhe depresionit sesa paraardhësit tanë. Ndjenjat tona komplekse mund të mos jenë gjithmonë të këndshme, por ato janë pjesë e transformimeve kryesore që krijuan komunitete të mëdha dhe të ndërlidhura. Kjo pasi emocionet tona janë thelbësore për bashkëpunimet njerëzore. / “The Conversation” – Bota.al



Ballkani fiton derbin ndaj Gjilanit

PRISHTINË, 2 TETOR - Skuadra kampione në fuqi, Ballkani është rikthyer me fitore në shtëpinë e saj pas shtrimit të tapetit të ri të fushës në Suharekë. Portokallezintë, të dielën, në kuadër të javës së 9-të iu gëzuan fitores para tifozëve të vet në duel me Gjilanin, me rezultat 2:0. Shifrat e këtij dueli i zhblokoi lojtari mysafir Arbër Prekazi, i cili shënoi autogol, në përmbyllje të pjesë së parë. Ndërkaq, shifrat në 2:0 i shtoi Meriton Korenica, pas një aksioni të shkëlqyeshëm. Kësisoj, Ballkani pas shtatë ndeshjeve të zhvilluara deri më tash (dy ndeshje i ka të mbetura për shkak të angazhimeve në Ligën e Konferencës), ndodhet në pozitën e dytë më 18 pikë, tri më pak se skuadra e Dritës, e cila kryeson renditjen. Skuadra

kryesuese në renditje, Drita, ka shënuar fitoren e gjashtë në këtë edicion të garave. Skuadra e drejtuar nga Ardian Nuhiu në kuadër të javës së 9-të në Albi Mall Superligë ka shënuar fitore të vështirë para tifozëve të vet në duel me Drenicën, me rezultat 2:1. Drita kaloi në epërsi qysh në minutën e 5-të, me golin e Blend Baftiut. Megjithatë, Drenica barazoi shifrat në minutën e 43-të nga penalltia, e akorduar nëpërmjet VAR-it. I saktë nga penalltia ishte Bintsouka Koxy. Këmbëngulja e futbollistëve të Dritës për të gjetur golin e fitores dha rezultat në minutën e 87-të, kur Ardit Tahiri shënoi me gjuajtje me kokë pas harkimit të Besnik Krasniqit. Ndërkohë, Llapi ka barazuar në shtëpi me rezultat 1:1 në duel me Malishevën. Llapjanët kaluan të



parët në epërsi me supergolin e Benjamit Emimit me gjuajtje nga distanca, në minutën e 33-të, teksa rezultatit e barazoi në minutat shtesë të pjesës së parë Fiton Hajdari. E fitoren e parë në këtë edicion e ka realizuar Dukagjini dhe atë me rezultat

bindës, 4:1 në përballje me Ferizajn. Të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e Enis Sefës (8'), por Dukagjini e përmbysti rezultatit qysh në pjesën e parë me golat e Altin Merlakut (23') dhe Dior Zabërgjës (45'+3'), derisa që

fitorja të jetë edhe më bindëse u përkujdesën Dior Zabërgja (51') dhe Otto John (70') nga penalltia.

SUPERLIGA - Java 9

Ballkani - Gjilani	2-0
Drita - Drenica	2-1
Llapi - Malisheva	1-1
Dukagjini - Ferizaj	4-1
Prishtina - Trepça '89	

Tabela		Pikë
1. Drita	9	21
2. Ballkani	7	18
3. Gjilani	9	14
4. Prishtina	8	12
5. Drenica	9	11
6. Trepça '89	7	9
7. Llapi	8	9
8. Malisheva	9	8
9. Ferizaj	9	7
10. Dukagjini	9	5

Ponte Prizreni ia shkaktonte humbjen e katërt kampionëve, Peja shënon fitoren e katërt

PRIZREN, 2 TETOR - Ponte Prizreni ka shënuar fitore ndaj Golden Eagle Yllit me rezultat 98:82 (24:11, 23:14, 29:24, 22:32), në xhiron e katërt të Prince Caffè Superligës. Për Yllin, kjo ishte humbja e katërt në katër ndeshje. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë, me një epërsi prej pesë pikësh, 10:5, që shkuan duke e shtuar atë dhe çerekun e parë e fituan bindshëm 24:11, ku shkëlqeu Dashon Burke në fund të kësaj pjese. Prizrenasit vazhduan me lojë të mirë në periudhën e dytë, duke e thelluar epërsinë, ku shkuan në pushim me rezultat 47:25. Epërsia më e lartë ishte 30 pikë, 59:29 për vendasit, që u krijoi komoditet për vazhdim të ndeshjes, ndërsa rezultati në semafor



pas 30 minutash ishte 76:50. Kampioni tentoi të rikthehet në dhjetë minutat e fundit, por ishte tepër e vështirë dhe pësuan humbjen e katërt në katër ndeshje të zhvilluara,

derisa rezultati përfundimtar ishte 98:82, ndërkohë, prizrenasit kanë dy fitore e dy humbje. Te Ponte Prizreni u dalluan Wayne Arnold me 28 pikë e nëntë kërcime, Ivan

Koljeviq me 17 pikë e 13 kërcime dhe Dachon Burkert me 30 pikë, kurse te Golden Eagle Ylli u dalluan Valon Bunjaku me 17 pikë e tetë kërcime, Henrik Sirko me 19 pikë e pesë kërcime dhe Bashir Ahmed me 26 pikë. Peja ka shënuar fitoren e katërt në këtë edicion nga katër ndeshje. Në një atmosferë fantastike në Gjakovë, verdhezinjtë kanë mundur Vëllaznimin me rezultat 63:75 (15:28, 24:14, 12:18, 12:15). Pesë minutat e parë ishin të barabartë, por më pas pejanët morën lojën në duar, duke e kontrolluar dhe duke e fituar çerekun e parë me rezultat 15:28. Kuqezinjtë nuk u dorëzuan dhe e filluan furishëm periudhën e dytë, me një seri prej 10:0, për të afruar

rezultatit në 25:28, e më pas zhvillohet lojë e baraspeshuar, ku skuadrat shkuan në pushim me rezultat 39:42. Mysafirët e nisën më mirë periudhën e tretë, për tu shkëputur në 11 pikë, 41:52 dhe kishin epërsi konstante në këtë pjesë, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 51:60. Në dhjetë minutat e fundit vendasit u munduan të rikthehen dhe të shkrijnë rezultatit, por nuk ia arritën qëllimit dhe Peja shënoi fitoren e katërt në këtë edicion nga katër ndeshje, 63:75, kurse kuqezinjtë kanë një fitore e tri humbje. Damonte Dodd ishte më i miri te Vëllaznimi me 14 pikë e 12 kërcime, kurse te Peja më i dalluari ishte Rodney Purvis me 30 pikë.

Duka e Ademi vizitojnë Thaçin dhe Veselin në Hagë

Hagë, 2 tetor - Presidenti i FSHF-së, Armand Duka dhe ai i FFK-së, Agim Ademi kanë vizituar Hashim Thaçin e Kadri Veselin në burgun e Hagës. Kreu i FSHF-së, Duka njoftoi se atje u takuan me Thaçin e Veselin, që po mbahen në paraburgim në Hagë të Holandës. "Sot pasdite isha në burgun e Hagës, Hollandë. Bashkë me Presidentin e Federatës së Kosovës Agim Ademi, e anëtarin e komitetit ekzekutiv të FFK-së Mirsad Çollaku, u takuam e

bashkëbiseduam me dy miq, dy figura me gjurmë të padiskutuueshme në historinë e Kosovës dhe shqiptarisë, Hashim Thaçin e Kadri Veselin. Kjo historia e burgut, është sprovë e fundit për ta. Dhe në çdo rast do të dalin të fituar për ti dhënë fund njëherë e mirë të gjitha pretendimeve për të përbaltur UÇK-në dhe luftën për pavarësi të popullit të Kosovës. Me erdhi shumë mirë që ishin mirë me shëndet dhe për më tepër për minuta të tëra folëm dhe për futbollin. Sa

mirë e sa para kanë ecur Shqipëria e Kosova në këtë drejtim. Hashimi gjithmonë ka qenë një ndjekës i rregullt edhe në stadium. Dhe kjo e Hashimit dhe Kadriut është e ngjashme me lojërat që bëjmë në fushë. Kemi hedhur në fushë lojtarët më të mirë të kombëtareve tona. Ndaj do dalim të fituar. Hashim & Kadri, gjithë komuniteti i futbollit Shqipëri-Kosovë por edhe në gjithë trevat shqipfolëse është me ju", ka thënë Duka.



Prevod sa albanskog na srpski jezik

REPUBLIKA KOSOVO
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI

C. br. 65/2019

OSNOVNI SUD U PRIŠTINI, Opšte odeljenje, sa sudijom Ujvesë Hysenaj, u parničnoj pravnoj stvari tužioca Lutfi Hoxha iz Prištine, koga zastupa Shefki Sylja, advokat iz Prištine, protiv tuženog Deoničarsko društvo, Trgovinsko preduzeće za promet na veliko i malo „Nish Promet“ Obrenovac br. 42 sa nepoznatom adresom, sa predmetom spora utvrđivanje prava svojine, van ročišta, dana 20.09.2022. godine, doneo je sledeće:

REŠENJE

- I. Tuženom Deoničarsko društvo, Trgovinsko preduzeće za promet na veliko i malo „Nish Promet“, Obrenovac, sada sa nepoznatom adresom, postavlja se privremeni zastupnik u ovoj parničnoj pravnoj stvari.
- II. Za privremenog zastupnika se tuženom pomenutom pod tačkom I ovog rešenja, postavlja Vigan Rogova, advokat iz Prištine.
- III. Privremeni zastupnik će zastupati tuženog dok se on ili njegov punomoćnik ne pojavi pred sudom i isti ima sva prava i obaveze pravnog zastupnika.
- IV. U vezi sa ovim rešenjem, sud će u roku od 7 dana izdati pismeni oglas koji će biti objavljen u Službenom listu i postavljen na oglasnu tablu ovog suda.

Obrazloženje

Tužilac Lutfi Hoxha iz Prištine je preko svog punomoćnika, dana 11.01.201. godine, podneo ovom sudu tužbu protiv Deoničarskog društva, Trgovinsko preduzeće za promet na veliko i malo „Nish Promet“, Obrenovac, radi utvrđivanja prava svojine.

Sud je pokušao da tuženom dostavi rešenje radi dostavljanja odgovora na tužbu, tužbu i prateće dokaze, preko Ministarstva pravde, Odeljenja za međunarodnu pravnu saradnju na adresu tuženog, međutim isto je vraćeno uz konstataciju da je tuženi nepoznat.

Prevod sa albanskog na srpski jezik

Zastupnik tužioca je podneskom od 12.01.2022. godine upoznao sud da tužilac ne poseduje drugu adresu tuženog osim one koja je navedena u tužbi, stoga je predložio da mu se postavi privremeni zastupnik kako bi isti mogao da preduzima procesne radnje.

Članom 79. stav 3. Zakona br. 03/L-006 o parničnom postupku utvrđeno je sledeće: „Sud će odrediti optuženoj strani privremenog zakonskog zastupnika u sledećim slučajevima: a) ukoliko je mesto boravka optuženog nepoznato, a optuženi nema ovlašćenog zastupnika; ...“. Sud je ocenio predlog punomoćnika tužioca za postavljanje privremenog zastupnika za tuženog s obzirom na okolnosti u predmetu, a radi efikasnijeg procesiranja ove konkretne pravne stvari i našao da predlog treba da bude usvojen.

Privremeni zastupnik će zastupati tuženog sve dok se on ili njegov punomoćnik ne pojavi pred sudom i isti ima sva zakonska prava i obaveze zakonskog zastupnika.

Sa svega napred navedenog, a na osnovu odredbi člana 387. stav 1. tačka (q) u vezi sa članom 79.1, članom 79.3 tačka (a), članovima 81, 82. i 83. ZPP-a, odlučeno je kao u izreci ovog rešenja.

OSNOVNI SUD U PRIŠTINI
Opšte odeljenje
C. br. 65/2019 od 20.09.2022. godine

Sudija
Ujvesë Hysenaj
[Potpisano]

[Pečat: Republika Kosovo,
Osnovni sud u Prištini]

PRAVNA POUKA: Protiv ovog rešenja nije dozvoljena žalba.

U Prištini, dana 30.09.2022. g.
Da je prevod veran originalu, potvrđuje i overava sudski prevodilac Miradija Alijeviq.
Prevodilačka agencija „Alfa com“ Priština, e-mail: ag.alfacom@gmail.com, Tel: +377 (44) 661 303



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C.nr.65/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Ujvesë Hysenaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Lutfi Hoxha nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Shefki Sylja, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Shoqëria Aksionare, Ndërmarrja Tregtare Qarkulluese me pakicë dhe shumicë “Nish Promet”, Obrenovc, Nr. 42, me adresë të panjohur, me objekt të kontestit vërtetim pronësie, jashtë seancës gjyqësore, me datë 20.09.2022, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Të paditurës Shoqëria Aksionare, Ndërmarrja Tregtare Qarkulluese me pakicë dhe shumicë “Nish Promet”, Obrenovc, tani me adresë të panjohur i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm në këtë çështje juridike kontestimore.
- II. Përfaqësuesi i përkohshëm të paditurin e përmendur në pikën I të këtij aktvendimi caktohet Vigan Rogova, avokat nga Prishtina.
- III. Përfaqësuesi i përkohshëm do të përfaqësoj të paditurën derisa i autorizuar i saj të mos paraqitet në gjykatë dhe i njëjti i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor.
- IV. Lidhur me këtë aktvendim gjykata brenda afatit prej 7 ditësh do të jap shpallje me shkrim e cila do të bohet në gazetën zyrtare dhe publikohet në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate.

Arsyetim

Paditësi Lutfi Hoxha nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tij, me datë 11.01.201. në këtë Gjykatë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Shoqëria Aksionare, Ndërmarrja Tregtare Qarkulluese me pakicë dhe shumicë “Nish Promet”, Obrenovc, lidhur me vërtetim pronësie.

Gjykata ka provuar që të paditurës të ja dërgoj aktvendimin për përgjigje në padi, padinë dhe provat përcjellëse, përmes Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për adresën e të paditurës, mirëpo e njëjta është kthyer me konstatimin se e paditura është e panjohur.

Përfaqësuesi i paditësit përmes parashtrësës me datë 12.01.2022, e ka njoftuar gjykatën se paditësi tjetër adresë të të paditurës nuk ka përveç asaj në padi, andaj ka propozuar t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm në mënyrë që i njëjti të mund të ndërmarrë veprime procedurale.

Me nenin 79, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se “Gjykata do t'i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste: a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurorë...”. Gjykata vlerësoi propozimin e të autorizuarit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën, duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe me qëllim të procedimit më efikas të kësaj çështje konkrete juridike gjeti se propozimi duhet të miratohet.

Përfaqësuesi i përkohshëm do të përfaqësoj të paditurën përderisa i autorizuar i tij të mos paraqitet në gjykatë dhe i njëjti i ka të gjitha të drejtat ligjore dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor.

Nga sa u parashtrua më lart, e në bazë të dispozitave të nenit 387 paragrafi 1 pika (q) lidhur me nenin 79.1, neni 79.3 pika (a), nenet 81, 82 dhe 83 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.65/2019, me datë 20.09.2022

Gjyqtarja
Ujvesë Hysenaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

